



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 23

Tiranë – E hënë, 13 shkurt 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 8.2.2023	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për heqjen e ndërsjellë të vizave për mbajtësit e pasaportave të zyrtarëve publikë dhe pasaportave të zakonshme..... 2303
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 27.12.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-364, datë 7.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore me praninë e palëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Shfuqizimin e VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” vetëm për sa i përket ZK 8524 Elbasan, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 2304
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 320, datë 12.12.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Albsolar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw..... 2318
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 321, datë 12.12.2022	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, bashkia Fier..... 2320
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 322, datë 12.12.2022	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, Bashkia Fier..... 2321
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 11, datë 23.1.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të HEC “Stromi”, në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a..... 2323

Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229,
datë 15.11.2021, “Mbi metodologjinë e llogaritjes së tarifës për
shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së”,
botuar në Fletore Zyrtare nr. 1, datë 5.1.2022.....

2324

**VENDIM****Nr. 68, datë 8.2.2023**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,
PËR HEQJEN E NDËRSJELLË TË
VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE TË ZYRTARËVE
PUBLIKË DHE PASAPORTAVE TË
ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për heqjen e ndërsjellë të vizave për mbajtësit e pasaportave të zyrtarëve publikë dhe pasaportave të zakonshme, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE
TË KINËS PËR HEQJEN RECIPROKE TË
VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE TË ZYRTARËVE PUBLIKË
DHE TË PASAPORTAVE TË ZAKONSHME**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Kinës (në vijim të referuara si “Palët Kontraktuese”);

me synimin për të promovuar më tej marrëdhëniet miqësore midis vendeve të tyre dhe lehtësimin e shkëmbimit të vizitave nga qytetarët e tyre;

pas kryerjes së konsultimeve miqësore për përjashtimin e ndërsjellë të vizave për mbajtësit e pasaportave të zyrtarëve publikë dhe pasaportave të zakonshme në bazë të barazisë dhe reciprocitetit; kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë që posedojnë pasaporta të zakonshme të vlefshme të Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit e Republikës Popullore të Kinës që posedojnë pasaporta të zyrtarëve publikë dhe pasaporta të zakonshme të vlefshme të Republikës Popullore të Kinës, përjashtohen nga kërkesat për vizë për hyrjen, daljen nga ose transitin përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese, për një periudhë qëndrimi jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, në çdo periudhë 180-ditore nga data e hyrjes së tyre.

Neni 2

Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, do të hyjnë në, do të dalin nga, ose do të kalojnë transit, përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese, përmes porteve të hapura për udhëtarët ndërkombëtarë dhe do të respektojnë formalitetet e nevojshme në përputhje me aktet ligjore përkatëse të autoriteteve kompetente të kësaj të fundit.

Neni 3

1. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese do të respektojnë ligjet dhe rregulloret në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit të tyre në territorin e saj, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në traktatet ndërkombëtare në të cilat të dy vendet janë Palë Kontraktuese.

2. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët synojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë prej më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditësh ose të studiojnë, banojnë, angazhohen në punësim, aktivitete mediatike ose aktivitete të tjera të cilat do të miratohen paraprakisht nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, do të aplikojnë për vizë përpara se të hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.



Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e asnjërës Palë Kontraktuese për të ndaluar personat e konsideruar persona “non grata”, ose shtetas të papranueshëm të Palës tjetër Kontraktuese të hyjnë në territorin e saj ose për të ndërprerë qëndrimin e tyre në territorin e saj pa përmendur arsyet për këtë.

Neni 5

Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë përkohësisht këtë Marrëveshje pjesërisht ose tërësisht për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit publik.

Megjithatë, ajo do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese paraprakisht me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike për qëllimin e saj për të pezulluar Marrëveshjen dhe më pas për të anuluar pezullimin.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese do të përfundojnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, shkëmbimin e modeleve të pasaportave të tyre të zakonshme të përmendura në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje, secila Palë Kontraktuese do të informojë Palën tjetër Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, 30 (tridhjetë) ditë para paraqitjes së saj, për çdo ndryshim në formatin e pasaportave të zakonshme dhe do t'i sigurojë kësaj të fundit modelin e pasaportave të reja të zyrtarëve publikë dhe pasaportave të zakonshme.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë) pas datës së njoftimit të fundit me shkrim nga Palët Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke specifikuar se janë përmbushur kërkesat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar. Nëse njëra Palë Kontraktuese dëshiron të përfundojë këtë Marrëveshje, ajo do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese me shkrim përmes kanaleve diplomatike dhe kjo Marrëveshje

do ta humbasë efektin e saj në ditën e 90 (nëntëdhjetë) pas datës së njoftimit.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve Kontraktuese.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 16.1.2023, në gjuhën shqipe, kineze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Zëvendësministër për Evropën dhe Punët
e Jashtme
Megi Fino

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS POPULLORE
TË KINËS
Ambasador
SH.T.Z. Zhou Ding

VENDIM

Nr. 43, datë 27.12.2022

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 22.11.2022 dhe 16.12.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 6 (M) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Minerva Kotherja, Ferzilet Sarja, Myzejen Caku, Ermira Garunja, Zëdlir Bylykbashi, Armand Bylykbashi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, Avokatura e Shtetit, Agjencia e Trajtimit të Pronës.

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-364, datë 7.3.2022, të Kolegjit Administrativ të



Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore me praninë e palëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Shfuqizimi i VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” vetëm për sa i përket ZK 8524 Elbasan, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronës (ATP), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit janë trashëgimtarë ligjorë të shtetases Sh.B., e cila, në cilësinë e ish-pronares, i është drejtuar ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Bashkisë Elbasan për kthimin dhe kompensimin e sipërfaqes truall të shtëpisë në pronësi të shtetaseve Xh.Gj. dhe Sh.B. (nënë e bijë), duke qenë se ato ishin shpronësuar vetëm për shtëpinë e shembur për nevoja të planit rregullues të qytetit. KKKP-ja, me vendimin nr. 373/2, datë 27.7.1994, ka vendosur kthimin fizikisht të sipërfaqes prej 137 m², si dhe kompensimin në vlerë të sipërfaqes së zënë me ndërtime të përhershme, prej 2,490 m².

2. Kërkuësja Minerva Kotherja, me kërkesën e datës 12.1.2009, i është drejtuar ish-Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), Tiranë për kompensimin financiar të sipërfaqes truall prej 2,490 m² sipas çmimeve të trojeve të përcaktuara në VKM-në nr. 139, datë 13.2.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës” (VKM nr. 139/2008). Me shkresën nr. 67/1 prot., datë 16.1.2009, AKKP-ja i ka kthyer përgjigje që të paraqitej pranë këtij organi me njoftimin e datave të tjera, pasi afati për paraqitjen e kërkesave kishte përfunduar më 3.12.2008.

3. Trashëgimtarët e ish-pronares Sh.B., i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për detyrimin e organit administrativ që të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit në favor të tyre. Me vendimin nr. 1340, datë 24.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim që është lënë në fuqi me vendimin nr. 2172, datë 25.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kurse me vendimin nr. 1783, datë 8.4.2014, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga AKKP-ja.

4. Pasi i është drejtuar me kërkesë AKKP-së për ekzekutimin vullnetar të detyrimit që rrjedh nga vendimet e sipërcituara, me kërkesën e datës 20.3.2013, kërkuësja Minerva Kotherja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 40, datë 30.9.2013, Gjykata ka vendosur rrëzimin e saj.

5. Me kërkesën e datës 1.11.2013, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për shkelje të nenit 6, pika 1 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të saj në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën për kompensim (aplikimi nr. 70211/13). Kjo kërkesë i është komunikuar shtetit shqiptar më 31.1.2015. Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të disa çështjeve të paraqitura në atë Gjykatë, ajo ka vendosur bashkimin e 77 kërkesave (ku bën pjesë edhe ajo e paraqitur nga kërkuësit) dhe shqyrtimin e tyre në një vendim të vetëm. Në lidhje me këto kërkesa, me vendimin e datës 8.9.2020 të Seksionit



të Dytë të GJEDNJ-së ato janë deklaruar të papranueshme, duke arsyetuar: “Në vitin 2012 Gjykata miratoi vendimin pilot në lidhje me këto çështje (Manushaqe Puto dhe të tjerë), në të cilin gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, në lidhje me kohëzgjatjen e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë që kanë njohur të drejtën e kompensimit, dhe shkelje të nenit 13 në lidhje me mungesën e mjeteve efektive të brendshëm. Për zbatimin e këtij vendimi pilot u miratua ligji i pronave i vitit 2015 që futi një mjet të ri kompensimi. Gjykata ka vlerësuar se mjeti i miratuar me ligjin e vitit 2015 është efektiv në kuptim të nenit 35 § 1 dhe nenit 13 të Konventës (shih Beshiri dhe të tjerë, § 215). Gjykata nuk gjen arsye të largohet nga ato gjetje në kontekstin e çështjes në shqyrtim dhe vlerëson se ankimet e aplikantëve sipas nenit 13 të Konventës janë haptazi të pabazuara dhe duhet të rrëzohen. Duke pasur parasysh gjetjet në vendimin Beshiri dhe të tjerë, §§ 224-29, i njëjti përfundim është i vlefshëm në lidhje me ankesat për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për zbatimin me efekt retroaktiv të ligjit të pronave të vitit 2015. Gjykata vlerëson se ky kërkim është gjithashtu haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet. Në lidhje me ankimet sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vëren se bazuar në fazën e procedurave në lidhje me secilin aplikim duhet të dallohen situatat e mëposhtme... Së dyti, në lidhje me... aplikimet nr. 70211/13, 70730/014 dhe 9152/15 (pikat 74-76 të Aneksit), Gjykata vëren se procedurat e brendshme në lidhje me përvaktimin e shumës së kompensimit janë në pritje para gjykatave vendase. Ndaj do të ishte e parakohshme që GJEDNJ-ja të merrej me këto ankesa, të cilat duhet të rrëzohen sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës (shih Beshiri dhe të tjerë, § 219). Praktika e Gjykatës së Lartë ka rikonfirmuar se në rast se është paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë vendimi i gjykatës më të ulët do të bëhet përfundimtar dhe i zbatueshëm pas vendimit të Gjykatës së Lartë” (shih paragrafët 18-24 të vendimit të GJEDNJ-së).

6. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (ligji nr. 133/2015) dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, ATP-ja, me shkresën nr. 1873/1, datë 27.5.2016, ka publikuar në Buletinin Zyrtar të Regjistratit të Vlerësimit vendimet përfundimtare që janë shprehur për njohjen e së drejtës së kompensimit për vitet 1993-1994. Sipas këtij vlerësimi, për subjektet e shpronësuar Xh.Gj. dhe Sh.B. për pronën e njohur me vendimin nr. 373/2, datë 27.7.1994 të KPPP-së, kompensimi për sipërfaqen prej 2,490 m²

truell është në vlerën 34,496,460 lekë. Duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, kërkesit i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë për kundërshtimin e vlerësimit të njëanshëm financiar të ATP-së dhe kompensimin me vlerën e pasurisë së paluajtshme truell sipas VKM-së nr. 139/2008. Rezulton se në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës të tokës në Republikën e Shqipërisë” (VKM nr. 89/2016), nuk ka pasur ndryshim të zërit kadastral për pasurinë e kërkuësve.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 54, datë 27.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Sipas asaj gjykate, procesi i ekzekutimit të vendimit nr. 373/2, datë 27.7.1994, të KPPP-së Elbasan ka filluar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015 dhe ai është bërë për sipërfaqen e tokës të llojit truell, pasi i tillë ka qenë zëri kadastral në momentin e shpronësimit, ndërsa vlerësimi i sipërfaqes së tokës është bërë sipas çmimeve të hartës së vlerës të miratuar me VKM-në nr. 89/2016 dhe se veprimtaria e organit administrativ për kryerjen e vlerësimit financiar është e ligjshme. Sipas saj, ligji i ri i pronave nr. 133/2015 në lidhje me masën e kompensimit ka përcaktuar një metodologji të ndryshme vlerësimi që ka sjellë një masë më të vogël kompensimi, por kjo mënyrë përlogaritjeje nuk është gjetur jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Në lidhje me pretendimin e ngritur në kërkesëpadi për cenimin e së drejtës së pronës private, gjykata e apelit ka vlerësuar se “shpërblimi i drejtë”, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës, nuk nënkupton shpërblimin sipas vlerës së tregut dhe se në rastin konkret nuk konstatohet një disbalancë në dëm të paditësve (kërkuësve), për rrjedhojë vlera e shpronësimit e njohur nga ATP-ja konsiderohet si shpërblim i drejtë. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-364, datë 7.3.2022, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësit, duke vlerësuar se të gjitha shkaqeve të parashtruara në të u është përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, kurse pretendimet që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se rekursi nuk përmban



shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

9. Me kërkesën e datës 20.6.2022, kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-364, datë 7.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të VKM-së nr. 89/2016, si të papajtueshme me Kushtetutën.

10. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin e datës 19.7.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve.

11. Në seancën plenare të datës 22.11.2022, Gjykata ka vendosur shtyrjen e saj për thirrjen si subjekt të interesuar të Këshillit të Ministrave, në kushtet kur objekt i kërkesës është edhe kontrolli i pajtueshmërisë me Kushtetutën i VKM-së nr. 89/2016.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt dhe asaj të pronës private, si vijon:

12.1 *Për vendimin nr. 00-2022-364, datë 7.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë kërkesit pretendojnë se cenon:*

12.1.1 *Parimin e sigurisë juridike dhe të gjësë së gjykuar*, pasi për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, kërkesve u është mohuar *apriori* një shkallë ankimi për shkak të mosshqyrtimit të ankimit në një gjykatë të shkallës së dytë dhe mungesës së vlerësimit ligjor ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Vendimi i kundërshtuar bie ndesh edhe me praktikën e vetë Gjykatës së Lartë, sipas së cilës vendimi i gjykatës së apelit merr formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në atë gjykatë, si shkallë e dytë e rigjykit.

12.1.2 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi është mbajtur standard i dyfishtë mes subjekteve të shpronësuar dhe ATP-së. Në rastet kur është pranuar padia e subjektit të shpronësuar, vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë, ndërsa kur është rrëzuar padia, vendimi konsiderohet i formës së prerë, duke i mohuar subjektit të shpronësuar

një shkallë ankimi në kundërshtim me nenin 13 të KEDNJ-së. Ky parim cenohet edhe sepse kërkesit gjenden në kushte pabarazie me shtetasit e tjerë, të cilëve u është vendosur pranimi dhe shqyrtimi në seancë gjyqësore i rekurseve të paraqitura përpara ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 49/2012.

12.1.3 *Parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private*, pasi vendimi objekt kundërshtimi nuk ka pasur në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, për vendimin e KKKP-së dhe formën e tij *quasi gjyqësore*. Duke qenë se vlerësimi i vitit 2016 ka anomalisht luhatur me zbritje në krahasim me vlerësimin e së njëjtës pasuri në vitin 2008, nuk është bërë një analizë e hollësishme e zbatimit korrekt të metodologjisë nga AKKP-ja, nuk janë analizuar pretendimet e kërkesve në lidhje me këtë dhe as nëse ato janë trajtuar ose jo nga gjykata e apelit. Sipas metodologjisë së vlerësimit të vitit 2008, vlera do të ishte 24,777 lekë m², ndërsa sipas asaj të vitit 2016, vlera ishte 13,854 m², duke sjellë një ulje me 40% të vlerës së pronës.

12.1.4 *Parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka administruar prova dhe dokumente, si: dokumentet justifikuese nga ATP-ja; dokumentacionin e metodologjisë së vlerësimit financiar konkret të ZK-së nga AKKP-ja; vlerësimin financiar konkret të ZK-së ose sipërfaqes objekt vlerësimi; provën me ekspert, të cilat do u garantonin kërkesve zhvillimin e debatit gjyqësor dhe të një hetimi të plotë për vlerën e trullit objekt gjykimi, pretendime që nuk janë trajtuar as nga Gjykata e Lartë. Për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, kërkesve nuk u është dhënë mundësia të dëgjohen në seancë gjyqësore lidhur me shkaqet e parashtruara dhe për të debatuar për vlerësimin financiar të realizuar në mënyrë të njëanshme nga ATP-ja.

12.1.5 *Standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka në përmbajtje një analizë juridiko-ligjore, nuk ka bërë interpretim ligjor të konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve.

12.2 *Për VKM-në nr. 89/2016, vetëm për sa i përket sipërfaqes prej 2,490 m², në ZK 8524 Elbasan, kërkesit pretendojnë se:*



12.2.1 Kërkuesit legjitimohen për kundërshtimin e këtij akti, pasi vlerësimi i financiar i ATP-së sipas njoftimit bazohet në përmbajtjen e VKM-së nr. 89/2016, prej së cilës ka ardhur pasoja e kundërshtuar gjyqësisht.

12.2.2 VKM-ja nr. 89/2016 cenon të drejtën e pronës private, në aspektin e shpërblimit të drejtë, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. ATP-ja nuk ka pasqyruar se si ka arritur në përfundimin se duhet zbatuar VKM-ja nr. 89/2016, pasi çmimi i saj nuk është real, dhe përse nuk i referohet VKM-së nr. 139/2008. Vlerësimet financiare sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për sipërfaqen prej 2,490 m², të ndodhur në ZK 8524, janë: 24,777 lekë/m², sipas VKM-së nr. 139/2008; 18,500 lekë/m², sipas VKM-së nr. 1620/2008; 5,583 lekë/m², sipas VKM-së nr. 187/2013; 12,234 lekë/m² sipas VKM-së nr. 514/2014; 13,584 lekë/m² sipas VKM-së nr. 89/2016.

12.2.3 Metodologjia për vlerësimin e pronave të paluajtshme është miratuar me VKM-në nr. 658, datë 26.9.2012 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” (VKM-ja nr. 658/2012). ATP-ja nuk ka provuar me dokumente ligjore se ka zbatuar këtë metodologji në veprimtarinë përgatitore përpara miratimit të VKM-së nr. 89/2016 dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vlerësuar nëse është respektuar kjo metodologji për nxjerrjen reale të vlerës financiare të pronës nga akti i kundërshtuar.

12.2.4 Jurisprudenca e GJEDNJ-së në lidhje me aplikimet për mosekzekutimin e vendimeve administrative të formës së prerë i referohet vlerësimit të parë të miratuar nga shteti shqiptar, pra atij të bërë me VKM-në nr. 139/2008.

13. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar vetëm në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e VKM-së nr. 89/2016, si vijon:

13.1 *Çështja nuk hyn në juridiksionin kushtetues*, duke iu referuar natyrës së kërimit dhe veçanërisht argumenteve mbi bazën e të cilave arsyetohet ky kërkim. Në thelb, kërkuesit pretendojnë mospërputhjen e këtij akti me VKM-në nr. 658/2012 dhe ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (ligji nr. 9235/2004), ndaj çështja e parashtruar i përket kontrollit të ligjshmërisë. Kërkuesit nuk e kanë arsyetuar çështjen në nivel kushtetues dhe shkaqet

e parashtruara nuk kanë të bëjnë as me çështje ligji, por me çështje fakti, që i përkasin hetimit gjyqësor. Kërkuesit kanë kërkuar shfuqizimin e këtij akti vetëm për sa i përket sipërfaqes së tyre në ZK 8534, Elbasan, ndërkohë që kontrolli abstrakt shtrihet mbi normën në tërësi dhe sjell efekte për të gjitha rastet e ngjashme.

13.2 Kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese për lidhjen shkakësore ndërmjet VKM-së nr. 89/2016 dhe pasojës negative në të drejtat kushtetuese. Ky pretendim është ngritur rishtazi para Gjykatës dhe nuk janë shteruar mjetet juridike në dispozicion, pasi nuk kanë ngritur më parë pretendime për antikushtetutshmërinë e aktit. Kërkuesit nuk legjitimohen as *ratione temporis*, pasi ata kanë marrë dijeni për VKM-në minimalisht në vitin 2016, kur kanë paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili është momenti kur akti ka filluar të prodhojë efekte për ta.

13.3 Skema e re e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ-ja, të cilat kanë vlerësuar se shpërblimi për ish-pronarët duhet të jetë i drejtë. I vetmi korrigjim që ka bërë GJEDNJ-ja ka të bëjë me miratimin e një tavani prej 10%, për diferencën që mund të ekzistojë mes zërave kadastralë të sotëm dhe të kohës së shpronësimit. Mekanizmi ligjor në fuqi kënaq interesat e ish-pronarëve, por nga ana tjetër siguron dhe ruan balancat ekonomike dhe financiare të shtetit. Ndryshimet në skemën për shpërblimin e ish-pronarëve sigurojnë ruajtjen e interesave konkurrues, duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e interesit publik, por duke siguruar edhe një shpërblim të drejtë për ish-pronarët.

14. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka prapësuar sa vijon:

14.1 *Kërkuesit nuk legjitimohen ratione temporis*, pasi kërkesa për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016 është paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Kërkuesit nuk legjitimohen as *ratione materiae*, pasi kërkesa nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe çështjet e parashtruara në të, në thelb, janë të natyrës ligjore, pasi i referohen pajtueshmërisë së metodologjisë me kuadrin ligjor të kohës, si dhe me standardet ndërkombëtare të vlerësimit. Në kërkesë ngrihen pretendime mbi faktet, duke referuar raportet që krijon VKM-ja nr. 89/2016 me ligjin nr. 133/2015. Për rrjedhojë,



shqyrtimi i tyre nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

14.2 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, me argumentin se Kolegji Administrativ ka mbajtur standard të dyfishtë midis subjekteve të shpronësuar dhe ATP-së, në rastet kur padia e subjektit është pranuar dhe vendimi i gjykatës së apelit konsiderohet i formës së prerë është i pabazuar. Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka juridiksion fillestar sipas ligjit nr. 49/2012, ka marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të parashtruara në kërkesëpadi. Në pjesën urdhëruese të vendimit ajo është shprehur edhe në lidhje me të drejtën e ankimit. Kurse Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin në përputhje me kompetencën e saj për të vlerësuar shkaqet e pranimi ose jo të tij.

14.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronës private, kërkuessit kanë parashtruar argumente që kanë të bëjnë me themelin e çështjes, të cilat janë ngritur në gjykimin në apel dhe kanë marrë prej asaj gjykate përgjigje shteruese.

14.4 Në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, parimin e sigurisë juridike dhe mosrespektimin e gjësë së gjykuar, që lidhen me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit, bazuar edhe në jurisprudencën kushtetuese, ato janë haptazi të pabazuara. Çështja është shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit në seancë publike, sipas rregullave të gjykimit në shkallë të parë, duke u garantuar palëve një proces të rregullt. Gjykata e Lartë, si shkallë e fundit e gjykimit, ka kompetencë të zhvillojë gjykimin edhe pa praninë e palëve, bazuar vetëm në shkaqet e parashtruara në rekurs, shqyrtim që garanton të drejtat substanciale të aksesit, të ankimit dhe për t'u dëgjuar. Kërkuessit i mbështetën pretendimet mbi argumente që janë ngritur edhe gjatë gjykimit në apel, që lidhen me faktet dhe vlerësimin e provave, kërtime që nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë e aq më pak nga Gjykata Kushtetuese.

14.5 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar mbi shkaqet pse çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, si dhe mbi shkaqet për të cilat ka vendosur mospranimin e rekursit, konkretisht se kërkimet e parashtruara në të nuk janë nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

15. **Subjekti i interesuar ATP-ja**, nuk ka paraqitur parashtrime pranë kësaj Gjykate, edhe pse është njoftuar rregullisht për gjykimin.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessve

16. Sipas kërkuessve, ata legjitimohen për pretendimet e tyre në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, pasi kanë qenë palë në atë gjykim, në përfundim të të cilit është dhënë vendimi objekt kundërshtimi. Ata pretendojnë se legjitimohen edhe për kundërshtimin e VKM-së nr. 86/2016, pasi vlerësimi financiar i ATP-së, sipas njoftimit, bazohet në përmbajtjen e këtij akti, për rrjedhojë ai ka sjellë pasojat e kundërshtuara gjyqësisht.

17. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, kërkuessit nuk legjitimohen për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016, pasi nuk e kanë arsyetuar çështjen në nivel kushtetues dhe shkaqet e parashtruara nuk kanë të bëjnë me çështje fakti, që i përkasin hetimit gjyqësor. Pretendimet në lidhje me këtë akt janë ngritur rishtazi para Gjykatës, për rrjedhojë ata nuk kanë shteruar as mjetet juridike në dispozicion. Sipas këtij subjekti, kërkuessit nuk legjitimohen as *ratione temporis*, pasi ata kanë marrë dënimin për VKM-në nr. 89/2016 minimalisht në vitin 2016, kur kanë paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili është momenti kur akti ka filluar të prodhojë efekte për ta.

18. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, kërkuessit nuk legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016 është paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Kërkuessit nuk legjitimohen as *ratione materiae*, pasi kërkesa nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe çështjet e parashtruara në të, në thelb, janë të natyrës ligjore, pasi i referohen pajtueshmërisë së metodologjisë me kuadrin ligjor të kohës, si dhe me standardet ndërkombëtare të vlerësimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i tyre nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

19. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, sipas



neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134 pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

20. Ndërsa në lidhje me aktin normativ, kërkuksi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 31.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, në të cilin është zbatuar edhe VKM-ja nr. 89/2016, për rrjedhojë janë bartës të së drejtës së pronës private dhe asaj për proces të rregullt të pretenduara të cenuara, pra provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Për sa i takon kriterit të shterimit të mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuksi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të

gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

23. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual me objekt kundërshtimin si të pajtueshëm me Kushtetutën të ligjit ose aktit normativ, Gjykata ka theksuar se, si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individit duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato në gjykatat kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuksi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 31, datë 4.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

24. Për sa u përket pretendimeve për procesin gjyqësor, kërkuksit, në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, kanë parashtruar edhe se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka administruar disa prova dhe dokumente, të cilat do u garantonin atyre zhvillimin e debatit gjyqësor dhe të një hetimi të plotë për vlerën e trullit objekt gjykimi dhe se këto pretendime nuk janë trajtuar nga Gjykata e Lartë. Gjykata, referuar përmbajtjes së rekursit dhe parashkrimeve të paraqitura në Gjykatën e Lartë, konstaton se një pretendim i tillë nuk është ngritur më parë nga kërkuksi, për rrjedhojë konsiderohet se ata nuk i kanë shteruar mjetet e ankimit në lidhje me të. Kurse për sa u përket pretendimeve të tjera në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë kërkuksit nuk kanë asnjë mjet tjetër ankimi përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

25. Për sa i përket kërimit në objektin e kërkesës që ka të bëjë me VKM-në nr. 89/2016, rezulton se kërkuksi kanë kundërshtuar në gjykatat e zakonshme aktin e vlerësimit të ATP-së, duke pretenduar se, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, vlerësimi financiar duhej bërë sipas çmimeve të tokës të përcaktuara me VKM-në nr. 139/2008, në zbatim të detyrimit të vendosur për



organin administrativ me vendimin e formës së prerë nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas tyre, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, i është dhënë fuqi prapavepruese dispozitave të ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 89/2016, duke i zbatuar ndaj një të drejte të fituar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Po kështu, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, është ndërhyrë te forma e prerë e një vendimi *sui generis*, siç janë vendimet e KKKP-së, ndërkohë që ndaj kërkuessve duhej aplikuar vlerësimi më i favorshëm për një të drejtë të fituar që në vitin 1994, duke zbatuar VKM-në nr. 139/2008.

26. Gjykata vlerëson se, edhe pse kërkuessit kanë pretenduar përgjatë proceseve gjyqësore se vlerësimi i pronës së njohur për kompensim nuk duhej të bëhej në bazë të VKM-së nr. 89/2016, por në përputhje me metodologjinë dhe vlerën e tokës të përcaktuar me VKM-në nr. 139/2008, në thelb pretendimet e tyre kanë të bëjnë me mungesën e një vlerësimi real dhe të drejtë të pronës nga ky akt nënligjor, çka ka çuar në një vlerësim të njëanshëm dhe jokushtetues, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës që garanton të drejtën e pronës private dhe shpërblimin e drejtë. Për rrjedhojë, konsiderohet se kërkuessit i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion edhe në lidhje me kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016. Po kështu, ata kanë kundërshtuar në gjykatat e zakonshme aktin individual të vlerësimit të nxjerrë nga ATP-ja, gjykim gjatë të cilit kanë ngritur edhe pretendimet për antikushtetutshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore ku është bazuar ai. Për rrjedhojë, ata i kanë shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë përpara se t'i drejtohen Gjykatës me ankim kushtetues individual.

27. Kërkuessit legjitimohen *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 7.3.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 20.6.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

28. Në lidhje me VKM-në nr. 89/2016, përveç afatit të parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se individët mund të paraqesin kërkesë për papajftueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4

muajve nga konstatimi i cenimit. Pra, në rastin e ankimit kushtetues individual konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por ai llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuessin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ. Kërkuessit e kanë kundërshtuar VKM-në nr. 89/2016 së bashku me vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar pretendimet për vlerësimin financiar individual të bërë në zbatim të ligjit nr. 133/2015 dhe të kësaj VKM-je, ndaj afati 4-mujor llogaritet nga data e vendimit të fundit gjyqësor që është dhënë bazuar mbi këtë akt, ai i Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, kërkuessit legjitimohen *ratione temporis* edhe për kundërshtimin e aktit nënligjor.

29. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuessit kanë pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të gjësë së gjykuar, pasi shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit u ka mohuar *apriori* një shkallë ankimi për shkak të mosshqyrtimit të ankimit në një gjykatë të shkallës së dytë dhe mungesës së vlerësimit ligjor ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Sipas tyre, vendimi bie ndesh edhe me praktikën e vetë Gjykatës së Lartë, sipas së cilës vendimi i gjykatës së apelit merr formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në atë gjykatë, si shkallë e dytë e rigjykimit. Po kështu, ata kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë mbajtur standard të dyfishtë mes subjekteve të shpronësuar dhe ATP-së dhe se ata janë vendosur në kushte pabarazie me shtetasit e tjerë, të cilëve u është vendosur pranimi dhe shqyrtimi në seancë gjyqësore i rekurseve të paraqitura para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 49/2012. Gjykata vlerëson se, në thelb, këto pretendime të kërkuessve lidhen me përmbajtjen e normave ligjore që kanë përcaktuar juridiksionin gjyqësor për shqyrtimin e këtyre llojeve çështjesh, si edhe rregullat procedurale të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Kërkuessit nuk kanë arritur t'i ngrenë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojnë se cenimi i pretenduar i të drejtave të tyre kushtetuese është rezultat i procesit gjyqësor dhe vendimarrjes gjyqësore të kundërshtuar. Po kështu, pretendimet lidhur me mënyrën e vlerësimit të provave dhe të zbatimit të dispozitave të ligjit material dhe atij procedural, si edhe mosrespektimin e vendimeve



unifikuese të Gjykatës së Lartë, kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

30. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarve në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, që kanë të bëjnë me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, atë të arsytimit të vendimit, si edhe parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private, duke qenë pretendime me natyrë kushtetuese, ato përfshihen në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë në vijim do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

31. Në lidhje me pretendimet e kërkuarve për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016, Gjykata vëren se si gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme, ashtu edhe në kërkesën në shqyrtim, ata kanë pretenduar se vlerësimi i pronës së tyre në bazë të ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 89/2016 është i njëanshëm e jokushtetues dhe nuk përbën një shpërblim të drejtë në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës. Sipas tyre, vlerësimi i pronës së njohur për kompensim nuk duhet të bëhet në bazë të VKM-së nr. 89/2016, i cili është zbatuar në këtë rast me efekt prapaveprues në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, edhe pse për kërkuarët kishte një vendim gjyqësor të formës së prerë që detyronte organin administrativ të vepronte në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të bënte vlerësimin e pronës sipas vlerës së tokës në fuqi në atë kohë, e cila, gjithashtu, ishte edhe më e favorshme për ta.

32. Gjykata rithekson se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit, janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 7, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të

zakonshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se gjykatat kombëtare kanë detyrë parësore të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit dhe se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e tyre në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale. Megjithatë, edhe pse roli i GJEDNJ-së mund të jetë i kufizuar në kuptimin e vlerësimit dhe interpretimit të ligjit të brendshëm, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë kombëtare ka zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast konkret, i cili mund të ketë rezultuar në kufizim/mohim të së drejtës, pra kur vendimet e gjykatave janë dukshëm arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Anbeuser-Busch Inc. kundër Portugalisë, datë 11 janar 2007 § 83; Kuznetsov dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 11 janar 2007, §70, 74 dhe 84*).

34. Në vështrim të sa më sipër, duke qenë se në thelb kërkuarët kanë pretenduar se vlera e pronës e përcaktuar sipas VKM-së nr. 89/2016 nuk është në përputhje me konceptin “shpërblim i drejtë”, sipas nenit 41 të Kushtetutës, të gjitha pretendimet e parashtruara në kërkesë që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përmbajtjen e aktit nënligjor do të trajtohen në këndvështrim të së drejtës kushtetuese të pronës private.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

35. Sipas kërkuarve, për shkak të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi, atyre nuk u është dhënë mundësia të dëgohen në seancë gjyqësore lidhur me shkaqet e parashtruara dhe për të debatuar për vlerësimin financiar të realizuar në mënyrë të njëanshme nga ATP-ja.

36. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, çështja është shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit në seancë gjyqësore publike, sipas rregullave të gjykimit në shkallë të parë, duke u garantuar palëve një proces të rregullt. Gjykata e Lartë, si shkallë e fundit e gjykimit, ka kompetencë të zhvillojë gjykimin edhe pa praninë e palëve, bazuar vetëm në shkaqet e parashtruara në rekurs, shqyrtim që garanton të drejtat substanciale të aksesit, të ankimit dhe të asaj për t'u dëgjuar.

37. Gjykata vëren se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të



barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 22, datë 22.9.2002; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 28, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Duke e vlerësuar procesin gjyqësor të zhvilluar në çështjen e kërkuarve në tërësinë e tij, Gjykata vëren se gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit kërkuarët janë përfaqësuar nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, duke u dëgjuar e parashtruar pretendimet dhe kërkimet e tyre. Pasi janë njohur me vendimin e asaj gjykate, kërkuarët kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs, ku kanë parashtruar kundërshtitë e tyre në lidhje me atë vendimmarrje, si dhe kanë paraqitur edhe kundërshtitë për prapësimet e kundërrekursit të Avokaturës së Shtetit. Po kështu, pretendimet e kërkuarve në këndvështrim të respektimit të këtij parimi u referohen vetëm procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe kanë të bëjnë me faktin se ai gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit, ndërkohë që ata nuk kanë ngritur pretendime për mungesën e njoftimit ose për mosmarrjen dijeni për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit.

39. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit*

processum. Në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 3, datë 11.2.2021; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar parashikimeve të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012, që rregullojnë procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, pikat 1 dhe 2 të nenit 61 parashikojnë se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, kurse neni 62 ka përcaktuar rastet kur gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe procedurën që ndiqet në një rast të tillë.

40. Gjykata vlerëson se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, *nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse*. Për rrjedhojë, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt.

41. Për sa më sipër, nuk rezulton që kërkuarët të jenë vendosur në pozita të pabarabarta me subjektin e interesuar, për rrjedhojë ky pretendim është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

42. Sipas kërkuarve, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka në përmbajtje një analizë juridiko-ligjore, nuk ka bërë interpretim ligjor të konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të parashtruara nga palët.

43. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, ky pretendim është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar mbi shkaqet pse çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, si dhe mbi shkaqet për të cilat ka vendosur mospranimin e rekursit, konkretisht se kërkimet e parashtruara në të nuk janë nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

44. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor.



Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Duke verifikuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe ka vlerësuar se në të “*nuk ngrihen problematika që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material apo procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Po ashtu, asnjë vendimarrje në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ apo të Kolegjeve të*

Bashkuara të Gjykatës së Lartë ose shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga rekursuesit në mjetin e ankimit para Gjykatës së Lartë.”. Sipas asaj Gjykate, të gjitha shkaqet të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, duke bërë një analizë të hollësishme të dispozitave të ligjit nr. 133/2015, që rregullojnë mosmarrëveshjen objekt gjykimi, kurse pretendimet për çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në përfundim, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se rekursi nuk i përmbahet shkaqet të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, ndaj duhet të vendoset mospranimi i tij (*shih paragrafët 20-22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

47. Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit, pretendimet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, ku ajo u jep përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, Gjykata e Lartë ka përmbushur standardet e mësipërme të arsyetimit në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

48. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.3 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronës private

49. Sipas kërkuarve, për vlerësimin e pronës së tyre nuk janë mbajtur në konsideratë jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, ajo e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së për vendimin e KKKP-së dhe formën e tij *quasi gjyqësore*. ATP-ja dhe gjykatat nuk kanë arritur të argumentojnë se përse duhej zbatuar VKM-ja nr. 89/2016, e cila nuk përmban një çmim real, dhe jo VKM-ja nr. 139/2008, e cila ishte në fuqi në kohën kur me vendim gjyqësor të formës së prerë është vendosur detyrimi i organit administrativ që të bënte vlerësimin e pronës së kërkuarve sipas vlerës së kësaj VKM-je, e cila ishte më e favorshme për ta. Jurisprudenca e GJEDNJ-së në lidhje me aplikimet për mosekzekutimin e vendimeve administrative të formës së prerë i referohet vlerësimit të parë të miratuar nga shteti shqiptar, pra VKM-së nr. 139/2008. Sipas metodologjisë së vlerësimit të vitit 2008 vlera do të



ishte 24,777 lekë m², ndërsa sipas asaj të vitit 2016 vlera ishte 13,854 m², duke sjellë një ulje me 40% të vlerës së pronës. Vlerësimi i pronës në bazë të ligjit nr. 133/2015 dhe VKM-së nr. 89/2016 është i njëanshëm e jokushtetues dhe nuk përbën një shpërblim të drejtë në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës.

50. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se skema e re e procesit të kthimit të kompensimit të pronave është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ-ja, të cilat kanë arritur në përfundime të njëjta se shpërblimi për ish-pronarët nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë dhe se ndërhyrjet ligjore synojnë pikërisht përfundimin e këtij procesi në mënyrë të drejtë. GJEDNJ-ja ka përcaktuar vetëm një kufi prej 10% që duhet të respektohet ndërmjet vlerësimit sipas zërit kadastral të sotëm dhe zërit kadastral të kohës së shpronësimit.

51. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, për pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronës private, kërkuesit kanë paraqitur argumente që kanë të bëjnë me themelin e çështjes, të cilat janë ngritur në gjykimin në apel dhe kanë marrë prej saj përgjigje në mënyrë shteruese.

52. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

53. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar lidhja që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kushtetuese, Gjykata e ka analizuar sigurinë juridike të lidhur edhe me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të kësaj Gjykate nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 10, datë 4.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Për sa i përket së drejtës së pronës private, neni 41 i Kushtetutës parashikon jo vetëm që kjo e

drejtë është e garantuar (pika 1), por edhe se ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e saj vetëm për interesa publike (pika 3), të cilët lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (pika 4), ndërkohë që për masën e këtij shpërblimi mund të bëhet ankim në gjykatë (pika 5). Në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'i nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe kufizimet e pronës. Për sa i përket konceptit të shpërblimit të drejtë, Gjykata e ka interpretuar të lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Ajo ka vlerësuar se e drejta e pronës, në kuptimin që i jep neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të barazohet me kuptimin që ka në vetvete e drejta dhe se e drejta e pronës nuk njësohet me të drejtën e kthimit të saj. Referuar kriterit kushtetues të “shpërblimit të drejtë”, Gjykata ka theksuar se shpërblimi ose kompensimi në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Në lidhje me parashikimet e ligjit nr. 133/2015 dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, Gjykata ka vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave që lidheshin me vlerën e kompensimit të pronave. Në vendimin e parë të saj nr. 1, datë 16.1.2017, edhe pse ka vendosur shfuqizimin e pikave 3 dhe 5, të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015, pasi cenonin parimin e sigurisë juridike, për sa i takon skemën së rivlerësimit për pronat e tjera, Gjykata është shprehur se metodologjia dhe formula e parashikuar nga ligji nr. 133/2015 ndërhyjnë në të



drejtën e pronës private, por kjo ndërhyrje respekton elementet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Në vlerësimin e Gjykatës skema e re e kompensimit ka ndryshuar metodën e vlerësimit, e cila mund të rezultojë në një masë kompensimi më të ulët se sa ajo e parashikuar nga ligjet e mëparshme, të cilat kishin krijuar pritshmëri për marrjen e kompensimeve sipas vlerës së tregut të pronës në momentin e nxjerrjes së vendimit për kompensimin. Ndonëse masa më e ulët e kompensimit nuk mund të cilësohet si shpronësim formal, ajo mund të cilësohet si një “ndërhyrje tjetër”, e cila, pavarësisht se mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për subjektet e shpronësuara, në tërësinë e saj respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e kompensimit të pronës së tyre dhe, si e tillë, është në respektim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

57. Për sa i takon skemës së kompensimit, sipas kuadrit të ri ligjor, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kur vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit të dhënë më parë janë pa vlerë të përcaktuar, me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar (*shih vendimin Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 17.3.2020, paragrafi 196*).

58. Në lidhje me hartat e vlerësimit të vitit 2016, GJEDNJ-ja e ka konsideruar të pasaktë parashtrimin në lidhje me uljen drastike të çmimit të referencës dhe ka vërejtur se ky çmim për të njëjtën kategori kadastrale është rritur krahasuar me atë të supozuar në vitin 2014. Sipas saj, ish-ankuesit e suksesshëm në atë gjykatë kanë marrë kompensim (në vlerën e tregut) që ishte në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën materiale. Nëse hartat e vlerësimit të pronave të vitit 2016 pasqyrojnë vlera të sakta të pronës është një çështje fakti që duhet të përcaktohet përfundimisht nga autoritetet kombëtare (*po aty, paragrafët 197-199 të vendimit*).

59. Në vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, objekt i të cilit kanë qenë sërish dispozitat e ligjit nr. 133/2015 dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, Gjykata ka vlerësuar se sistemi aktual i vlerësimit të

pronës nuk respekton në të gjitha rastet prapun minimal prej 10% të vlerësimit financiar dhe, për këtë arsye, është një ndërhyrje jo proporcionale në të drejtën e pronës private. Në vlerësimin e Gjykatës kufizimi i së drejtës së pronës private ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së rregullimit nga pika 2 e nenit 7 të ligjit nr. 133/2015 të situatës të ndryshimit që ka pësuar zëri kadastral i pronës ndër vite, çka përbën një boshllëk ligjor, nga i cili vijnë pasoja negative për të drejtat kushtetuese të individëve, në rastin konkret e drejta e pronës private. Kjo mungesë e rregullimit ligjor të situatës që ka rezultuar nga ndryshimi i zërit kadastral, i ka mohuar kompensimin e drejtë kësaj kategorie subjektsh.

60. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsytimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Po kështu, Gjykata rritet detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës Evropiane në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



62. Gjykata vëren se kërkesja Minerva Kotherja, në cilësinë e trashëgimtares ligjore të ish-pronares Sh.B., me kërkesën e datës 12.1.2009, i është drejtuar AKKP-së për kompensimin financiar të sipërfaqes truall prej 2,490 m², sipas çmimeve të trojeve të përcaktuara në VKM-në nr. 139/2008. Me shkresën nr. 67/1 prot., datë 16.1.2009, AKKP-ja i ka kthyer përgjigje që të paraqitet pranë këtij organi me njoftimin e datave të tjera, pasi afati për paraqitjen e kërkesave kishte përfunduar më 3.12.2008. Në këtë situatë, trashëgimtarët e ish-pronares Sh.B., i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për detyrimin e organit administrativ që të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit në favor të tyre. Me vendimin nr. 1340, datë 24.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim që është lënë në fuqi me vendimin nr. 2172, datë 25.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kurse me vendimin nr. 1783, datë 8.4.2014 Gjykata e Latë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga AKKP-ja.

63. Pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi gjyqësor, kërkesja Minerva Kotherja i është drejtuar AKKP-së për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si dhe ministrit të Drejtësisë për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit nga institucioni i ngarkuar për këtë qëllim. Në përgjigjet e saj drejtuar edhe ministrit të Drejtësisë, AKKP-ja ka parashtruar se kërkesja nuk ka aplikuar për kompensim financiar, ndaj organi nuk mund të shprehet me vendim për pronën e pretenduar. Gjithashtu, ai e ka orientuar kërkesen që të aplikojë në përputhje me procedurat, kriteret dhe afatet e miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012.

64. Duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me kërkesën e datës 20.3.2013, kërkesja Minerva Kotherja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 40, datë 30.9.2013, ka vendosur rrëzimin e saj. Pasi ka vlerësuar sjelljen e kërkeses dhe të autoriteteve, Gjykata ka vlerësuar se nuk rezulton që AKKP-ja të ketë refuzuar dhënien e kompensimit ndaj kërkeses, por ka kërkuar respektimin e procedurës ligjore dhe paraqitjen e kërkesës për kompensim

brenda afateve të shpallura publikisht për këtë qëllim. Kërkesja Minerva Kotherja, pas dhënies së vendimit gjyqësor që kërkon të ekzekutohet, edhe pse ka pasur mundësinë që të aplikojë pranë AKKP-së në afatet dhe kushtet e përcaktuara për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave, nuk rezulton ta ketë bërë. Për më tepër, Gjykata ka vlerësuar se detyrimi i AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ në zbatim të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përbën një aspekt formal të procesit dhe jo një vendim përfundimtar që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për kompensimin e pronës. Në vlerësimin e Gjykatës, mosnxjerrja e aktit administrativ nga AKKP-ja nuk e pengon kërkesen të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës, nëpërmjet aplikimit dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.

65. Gjykata vëren se, sipas nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Në këtë kuptim, referuar situatës ligjore dhe faktike në rastin në shqyrtim, duke qenë se kërkesat e mëparshme të kërkesve nuk kanë respektuar afatet dhe kriteret për t'u pranuar për shqyrtim, organi administrativ ka qenë në pamundësi ligjore për shqyrtimin e tyre, ndaj ekzekutimi i vendimit nr. 373/2, datë 27.7.1994 të KKKP-së, pra veprimi konkret administrativ, është bërë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në kohën e kryerjes së tij. Vlerësimi i pronës së kërkesve rezulton të jetë bërë nga ATP-ja në përputhje me parashikimet dhe procedurat e ligjit nr. 133/2015 dhe sipas vlerës për m² që parashikonte akti nënligjor në fuqi në kohën e kryerjes së këtij vlerësimi (VKM-ja nr. 89/2016), për rrjedhojë kërkesit rezulton të kenë marrë kompensim financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën materiale.

66. Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i kësaj çështjeje nuk konstatohet ulje drastike e çmimit të referencës për sipërfaqen e truallit që iu është kompensuar kërkesve. Nga kërkesit nuk u provua nga pikëpamja faktike që harta e vlerësimit të pronave, sipas VKM-së në fjalë, të mos pasqyrojë vlera të sakta të pronës, ndërkohë që pretendimet e tyre në këtë drejtim kanë natyrë të



përgjithshme. Ata janë përpjekur t'ia kalojnë barrën e provës ATP-së, duke parashtruar se ky organ nuk provon me dokumente ligjore se ka zbatuar standardet e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, pasi nuk ekziston asnjë dokument vlerësimi financiar i pasurisë objekt gjykimi në vitin 2015 nga AKKP-ja ndërkohë që vlerësimi është bërë pa pasur një studim konkret, dhe se VKM-ja nr. 89/2016 nuk mbështetet në standardet e vlerësimeve ndërkombëtare të pasurive të paluajtshme të Shoqatës Evropiane të Vlerësuesve. Gjykata vëren se edhe vetë gjykatat e zakonshme, të cilat kanë shqyrtuar çështjen nga pikëpamja e ligjit dhe e fakteve, nuk kanë arritur në një përfundim të tillë. Gjykata rithekson se kriteri kushtetues është ai i shpërblimit të drejtë dhe jo i shpërblimit të plotë të pronës së njohur për kompensim, plotësimi i të cilit nuk vihet në dyshim nga zbatimi i VKM-së nr. 89/2016. Po kështu, në nenin 3 të ligjit nr. 133/2015 është përcaktuar fusha e zbatimit, si dhe shtrirja e efekteve për sa i takon vlerësimit financiar, edhe për ekzekutimin e të gjitha vendimeve që nuk janë zbatuar për njohjen e së drejtës së kompensimit, të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore. Kërkuesit nuk kanë pretenduar se ndodhen para ndonjë prej rasteve përjashtimore në të cilat nuk zbatohet ky ligj, ose para situatës së ndryshimit të zërit kadastral, por pretendimet e tyre kanë të bëjnë vetëm me çmimin për m² të zbatuar nga ATP-ja për vlerësimin financiar të kryer për pronën e njohur për kompensim.

67. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, është i pabazuar.

68. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesve duhet të rrëzohet, sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 27.12.2022.

Shpallur, më 6.2.2023.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Elsa Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 320, datë 12.12.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBSOLAR” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “ALBSOLAR PV PARK 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/5 prot., datë 7.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albsolar’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Albsolar PV Park 1’, me kapacitet të instaluar 2 mw, në Bisht Kamzë, Bashkia Durrës”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 10.11.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albsolar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga



centrali fotovoltaiik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 12.11.2022 dhe 14.11.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1874/4 prot., datë 18.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Po ashtu me shkresën nr. 1874/3 prot., datë 17.11.2022 ERE i është drejtuar edhe MIE-s duke i kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja dijeni e shkresës të japë qëndrimin e saj mbi sa vendosur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në vendimin e datës 8.11.2022, që licenca e prodhimit t'i lëshohet shoqërisë “Albsolar” sh.p.k. Deri më sot nuk rezulton të jetë përcjellë në ERE qëndrimi i MIE-s për sa kërkuar, ndaj vlerësohet vijimi me vendimarrjen përfundimtare të ERE-s për sa shprehur nga Bashkimi i shoqërive me vullnet të lirë, duke lënë mundësinë e rishikimit të vendimit të licencimit në rast se MIE do të shpreh qëndrimin e saj.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Albsolar” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c”

dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga se deklaruar nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaiik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albsolar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Albsolar Pv Park 1, me kapacitet të instaluar 2 MW për një afat 25-vjeçar.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në vijim të qëndrimit të MIE-s për sa vendosur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në vendimin e datës 8.11.2022, që licenca e prodhimit t'i lëshohet shoqërisë “Albsolar” sh.p.k.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 321, datë 12.12.2022

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN
AVENUE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 mw, NË POVELÇË,
BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039 prot., datë 6.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2014 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika

1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi aplikimi rezulton se shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”; për pikën 2.1, germat “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: shoqëria duhet të depozitonte në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin me datë të rifreskuar dhe vërtetimin përkatës për vetë shoqërinë “Sun Avenue” sh.p.k.

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative të saj, të nënshkruar dhe/ose vulosur.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE dhe pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat nuk rezultojnë të publikuara as në ekstraktin historik tregtar të QKB-së.

Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes financiare për financimin e projektit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës referuar vlerës së investimit të përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit original ose fotokopje të njëzuar me origjinalin.

Pika 2, dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- germa “a”: shoqëria duhet të plotësojë datën e fillimit të operimit të centralit dhe të bëjë me dije nëse ka filluar punimet apo fazën në të cilën ndodhen ato. Gjithashtu, shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 30



vjetëve të centralit fotovoltai, pasi nga rastet analoge, rezulton se teknikisht një panel nuk mund të ketë një jetëgjatësi më të madhe se 25 vite.

- germa “b”: shoqëria duhet të depozitojë kontratën nr. 2773 rep., nr. 876 kol., datë 23.9.2022, në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë shkresën e OSSH sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pikës 7 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për alikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 322, datë 12.12.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË POVELÇË, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/2 prot., datë 6.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, në Povelçë, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2013 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.



- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”; për pikën 2.1, germat “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për administratorin e saj, me datë të rifreskuar sipas parashikimit të nenit 8, pika 3, të rregullores së licencimit dhe gjithashtu të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë “Sunpower 2017” sh.p.k.

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative të saj të nënshkruar dhe/ose vulosur.

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore.

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat nuk rezultojnë të publikuara as në ekstraktin e QKB-së. Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes financiare për financimin e projektit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës referuar vlerës së investimit të përcaktuar

në kontratën me MIE-n dhe parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.

- germa “c”: plani i biznesit është depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokument në ERE origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa “a”: shoqëria duhet të bëjë me dije datën e fillimit të operimit të centralit. Po ashtu, duke qenë se shoqëria ka deklaruar se viti i ndërtimit të centralit është viti 2022, duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit, apo fazën në të cilën ndodhen ato. Gjithashtu shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 30 vjetësh të centralit fotovoltai, pasi nga rastet analoge të mëhershme, ka rezultuar se teknikisht një panel nuk mund të ketë një jetëgjatësi më të madhe se 25 vjet.

- germa “b”: kontrata nr. 2772 rep., nr. 875 kol., datë 23.9.2022, është depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokument në ERE origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

- germa “c”: shkresa e OSSH sh.a. nr. 2813/3 prot., datë 11.4.2022 “Miratim për pikë lidhje Central Fotovoltai” nga rezulton se centrali fotovoltai prodhues i subjektit “Sunpower 2017” sh.p.k. është depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokument në ERE origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pikës 7 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin



e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

3 Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 11, datë 23.1.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ERA HYDRO” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË HEC “STORI” NË FAVOR TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, germa “g”, neneve 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së

procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 66/1 prot., datë 19.1.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Era Hydro’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të HEC ‘Stori’ në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Era Hydro” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 66 prot., datë 10.1.2023, prot., ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e aseteve të HEC “Stori” në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë.

- Shoqëria “Era Hydro” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stori”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 8.4.2020, dhe është mbajtëse e licencës nr. 462, seria P20.

- Marrëveshja e Barrës Siguruese nr. 2962 rep., nr. 1288 kol., datë 7.6.2019 me Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. (në cilësinë e barrëmarrësit) është nënshkruar përpara se shoqëria të licencohej nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike (datë 8.4.2020).

- Për sa më sipër, ERE nuk mund të marrë në shqyrtim këtë kërkesë, për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barre siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. për transferimin e aseteve të HEC “Stori” në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 15.11.2021, “Mbi metodologjinë e llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 1, datë 5.1.2022, f. 140, bëhet korrigjimi i nenit 2, në rregulloren e këtij vendimi si vijon:

Neni 2 ishte:

“Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i kriterëve kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit të realizuar nga operatori i sistemit të GNL-së bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim, si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me parimet dhe rregullat e miratuara në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit natyror të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.5.2017, si dhe akteve të tjera rregullatore që parashikojnë aktivitetin e operatorit të sistemit të GNL-së.”

Neni 2 bëhet:

“Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i kriterëve kushteve dhe i mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit të realizuar nga operatori i sistemit të GNL-së bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim, si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me parimet dhe rregullat e miratuara në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit natyror të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s, si dhe akteve të tjera rregullatore që parashikojnë aktivitetin e operatorit të sistemit të GNL-së.”

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë